



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritim Evropian

Mbledhja nr. 62

Prishtinë, më 21. 12. 2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, S-2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Njomza Emini, Xhavit Haliti, Fatmir Xhelili, Bislim Zogaj, Donika Kadaj-Bujupi, Valdete Bajrami dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Vjosa Osmani, Arben Gashi dhe Slobodan Petroviç.

Të ftuar: zëvendësministrja e Ministrisë së Integritimit Evropian, Anila Statovci, me bashkëpunëtorë dhe ministri i Ministrisë së Administratës Publike, Mahir Yagcillar, me bashkëpunëtorë.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi, Njomza Emini, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i projektbudgetit për vitin 2017, për Ministrinë e Integritimit Evropian;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja njoftoi se për shkak të seancës së jashtëzakonshme që ishte mbajtur një ditë më parë, kishte kërkuar që mbledhja e planifikuar të shtyhet. Andaj, pyeti anëtarët se a pajtohen që sot të plotësojnë rendin e ditës edhe me pikat e rendit të ditës të mbledhjes së

planifikuar, që do të mbahej një ditë më parë, ku ishte planifikuar të raportojnë zëvendësministria e Ministrisë për Integritet Evropian, znj. Anila Statovci, kurse lidhur me shqyrtimin e Agjendës për Reforma Evropiane (ARE), është ftuar ministri për Administratë Publike, z. Mahir Yagcilar apo të organizohet një mbledhje tjetër.

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua me plotësimet e propozuara.

2. Shqyrtimi i projektbuxhetit për vitin 2017, për Ministrinë e Integritet Evropian

Kryetarja falënderoi znj. Anila Statovci, me bashkëpunëtorët e saj, për pjesëmarrje në Komision dhe tha se sot ju kemi ftuar që të na njoftoni më saktësisht se çka është planifikuar në buxhetin e vitit 2017 në ministrinë tuaj. Në bazë të një analize buxhetore, të përgatitur për ministrinë tuaj, shohim se ka ulje të buxhetit, krahasuar me buxhetin e vitit 2016.

Zëvendësministria Statovci, njoftoi se arsyeja e buxhetit më të ulët për vitin 2017 për Ministrinë e Integritet Evropian, është për shkak të metodologjisë se si është bërë kalkulimi nga ana e Ministrisë së Financave. Pra, është marrë prerja e marsit të vitit 2016, që i përket pagave dhe mëditjeve, që ka qenë për poste të paplotësuara dhe për staf që kanë marrë pushim, pa pagesë ose pushim të lehonisë. Ai boshllëk është minimizuar dhe pak ka arritur të kthehet pastaj në rishikime. Numri i përgjithshëm i stafit është 88, kurse 81 është numri i stafit të buxhetuar.

Valdete Bajrami, theksoi se NDI, për ne si Komision dhe për të gjithë deputetët, na ka përgatitur një analizë buxhetore, andaj kam disa pyetje:

1. Pse pritet të rriten subvencionet nga 50.000€ në 250.000€ dhe çka parashihet me këto subvencione?
2. A janë adresuar gjetjet e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), sipas raportit të fundit, në të cilin thuhet se Ministria e Integritet Evropian nuk e ka planifikuar mirë buxhetin dhe nga mosplanifikimi keni pasur problem me qiranë, diku 20.000 € a është adresuar kjo çështje dhe a është përmirësuar sistemi i dhënies së granteve, përmes kategorive të subvencioneve dhe transfereve?

Fatmir Xhelili, theksoi se duke shikuar raportin që na ka sjellë NDI, për ta analizuar, më interesojnë disa çështje:

1. Po shihet një trend i rënies së buxhetit në vitet vijuese, andaj cilët hapa i keni ndërmarrë në këtë drejtim dhe cilët hapa i keni ndërmarrë në planifikim të Kornizës afatmesme të shpenzimeve për 3 vitet e ardhshme, a i keni objektivat e qarta, si dhe a jeni të kënaqur me këtë trend të buxhetit, duke i marrë parasysh obligimet që do të dalin për ministrinë tuaj gjatë procesit të Stabilizim-Asociimit?
2. A keni ndërmarrë ndonjë hap për të gjetur ndonjë objekt të Qeverisë për të evituar qiranë?
3. Te subvencionet, nga të dhënat shihet se në vitin e kaluar, deri në qershor, janë shfrytëzuar shumë pak, kurse në 2017 është kërkuar rritje të subvencioneve. Çka keni nënkuptuar me kërkesën për rritje të subvencioneve?

Sekretari i Ministrisë së Integritetive, z. Demush Shasha, lidhur me çështjen e qirasë, sqaroi se ka të bëjë me pagesën e qirasë së zyrtarit të MIE-së në Bruksel, sepse zyrtari në fjalë e ka pasur postin e sekretarit të parë, prej vitit 2011 deri më 2015, pastaj pozita e tij është rritur në pozitën e këshilltarit të ministrit. Pra, këtë avancim, nuk kemi mundur ta parashohim, kur e kemi planifikuar buxhetin.

Te subvencionet, fillimisht u përqendrua në të gjeturat e raportit të Zyrës së auditimit.

Ai tha se viti 2014 ka qenë viti i parë me një shumë modeste të subvencioneve, diku 50 mijë € dhe ka qenë proces i ri, pra kur nuk kemi ditur të menaxhojmë si është më së miri. Në vitin 2015, është përmirësuar, dhe në janar të vitit 2016, kemi hartuar rregulloren e re, e cila ka ndryshuar

komplet mënyrën si jepen subvencionet dhe procesin e aplikimit e hap plotësisht, në mënyrë publike dhe kjo që kemi bërë, do të adresojë çështjen e dhënies së rekomandimeve.

Sa i përket KASH-it, janë disa aspekte, ku do të kërkojmë rritje të buxhetit, si në rritje të stafit, për shkak të përafrimit të legjislacionit me legjislacionin e BE-së, përkthimin e legjislacionit dhe koordinimit të ndihmës së jashtme, prandaj këtu kemi nevojë ta ndryshojmë buxhetin për vitin 2017, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, për rritjen e këtyre pozitive.

Kryetarja pyeti: Cilat janë kapacitetet buxhetore të përkthimit të legjislacionit të BE-së?

Demush Shasha, tha se është formuar një divizion, në kuadër të Ministrisë së Integritimit Evropian, për përkthimin e legjislacionit të BE-së, në bashkëpunim me GIZ-in. Është blerë programi për përkthimin e legjislacionit të BE-së, dhe me ministrin e Integritimit Evropian të Shqipërisë, kemi nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi dhe është ngritur një komision, i cili gjatë vitit 2016 ka pasur 4 takime. Jemi në hapat fillestarë dhe do të marrë kohë disa vite, derisa të përkthehet legjislacioni.

Fatmir Xhelili, pyeti: A mundeni ju që me këtë buxhet t'i realizoni detyrat e juaja dhe a ka nevojë që ne si Komision, të llojmë që me rishikim, të kthehet buxheti në gjendjen e mëparshme, pasi që po shohim se është reduktuar buxheti?

A ka MIE buxhet për lobim apo është vetëm në duar të Ministrisë së Punëve të Jashtme?

Kujtim Paqaku, pyeti: A ka përfituar ndonjë organizatë joqeveritare me komunitetet pakicë, me fokus tek romët dhe a është financuar ndonjë student rom nga kategoria transfere dhe subvencione?

Demush Shasha, tha se nuk i kanë financuar studentët e asnjë komuniteti, kurse sa i përket komunitetit rom, janë financuar disa projekte, saktë nuk e di, por mund t'ua dërgojmë më vonë, saktësisht.

Anila Statovci, njoftoi edhe për vizitën e fundit që e kishte pasur në Bruksel. Ajo tha se qëllimi i vizitës ishte fillimi i mbledhjes së parë të Nënkomitetit për Politika Sociale dhe Shoqëri Informative dhe është mbledhja e parë që është paraparë tani me strukturat e MSA-së. Po ashtu, në kuadër të kësaj vizite, kam organizuar takime të ndryshme me aktorët ndërkombëtarë, që bashkëpunojnë me ne. Në këto takime, kemi marrë përkrahje dhe na është thënë se, tani, me miratimin e suspendimit të liberalizimit të vizave, është një dritare vogël, nëse plotësohen dy kriteret e mbetura gjatë periudhës dhjetor-janar, arrijmë të hyjmë në diskutim me Ukrainën dhe Gjeorgjinë dhe ka gjasa të kalojë liberalizimi i vizave për Kosovën.

Në vazhdim, tha se MSA-ja paraqet një varg reformash që janë qenësore, si agjendë zhvillimore e reformave në Republikën e Kosovës. Po ashtu, theksoi se MIE ka mjaft punë dhe ne jemi në fillim, kurse si koordinatori kryesor i Qeverisë, duhet t'i koordinojmë të gjitha punët që priten nga ministritë e linjës, që nënkupton aktivitete të vazhdueshme dhe nevojë për shtim të kapaciteteve. Ajo shtoi se natyrisht ka mjaft vend për të lobuar për buxhetin e MIE-së, sepse është një buxhet jashtëzakonisht modest, me të cilin nuk mund t'i realizojmë detyrat e nevojshme.

Në fund, tha se lobimin nuk e kemi mandat, por shkon në kuadër të punës sonë dhe në BE, ne jemi pasqyra e tyre në raport me Qeverinë e Kosovës dhe këtu MIE luan një rol shumë të madh.

Valdete Bajrami, pyeti zëvendësministren: A po mund t'ia dilni pa ministër në ministri?

Anila Statovci, tha se unë e luaj rolin e ministrit dhe nuk po mbesin anash detyrat që duhet të bëhen.

Kryetarja falënderoi zëvendësministren, me bashkëpunëtorë për raportimin dhe njëherazi falënderoi edhe NDI-në për analizimin e buxhetit, si dhe GIZ-in për ndihmën në përkthimin e legjislacionit të BE-së.

3. Shqyrtimi i Agjendës për Reforma Evropiane (ARE)

Kryetarja falënderoi ministrin për pjesëmarrje dhe e pyeti atë: A mund të informoni lidhur me pakon legjislative mbi shërbimin civil, pagat dhe organizimin e reformës publike, çka është ndërmarrë deri më tani, sa i përket miratimit të kësaj pakoje legjislative dhe a ka ministria kapacitete për hartimin e kësaj pakoje dhe për udhëheqjen e reformës në administratën publike?

Mahir Yagcilar, ministër i Administratës Publike, gjatë raportimit të tij, paraqiti të arriturat dhe sfidat drejt përmbushjes së aktiviteteve në fushën e reformës së administratës publike, që rezultojnë nga Programi kombëtar për zbatimin e rekomandimeve, që dalin nga raporti i fundit i Komisionit Evropian për Kosovën.

Ai theksoi se procesi reformues, në mënyrë të vazhdueshme, ka ndihmuar dhe po vazhdon të ndihmojë në funksionimin e mirëfilltë të aparatit tonë shtetëror.

MSA-ja, ndër të tjera, përcakton që bashkëpunimi do të mbështesë, në veçanti, sundimin e ligjit, funksionimin e duhur të institucioneve shtetërore, për të mirën e popullsisë së Kosovës në tërësi dhe zhvillimin normal të marrëdhënieve mes BE-së dhe Kosovës. Programi kombëtar për zbatimin e MSA-së, parasheh që në kuadër të kriterëve për fushën e administratës publike që duhet plotësuar nga Qeveria dhe institucionet e Kosovës, mbetet miratimi i legjislacionit primar dhe sekondar, si dhe zbatimi i politikave dhe legjislacionit në tërësi. Deri në këtë fazë, kemi miratuar Ligjin për procedurat e përgjithshme administrative, dhe në fillim të vitit 2017, pritet të zhvillohen të gjitha përgatitjet e nevojshme për zbatimin e tij, përmes projektit IPA 2014.

Sa i përket 3 projektligjeve tjera, siç janë: Projektligji për organizimin e administratës publike, për pagat në sektorin publik, si dhe ai për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, në vazhdimësi është punuar në hartimin e tyre, dhe në disa raste, në plotësim-ndryshim. Në bashkërendim me përfaqësuesit e Komisionit Evropian dhe me mbështetjen SIGMA-s, tani ndodhemi në fazën e finalizimit të koncept-dokumenteve të reja për 3 projektligjet e lartpërmendura. Me funksionalizimin e mëtejshëm elektronik të Sistemit për menaxhimin e informatave të burimeve njerëzore në shërbimin civil, së bashku me klasifikimin e vendeve të punës, krijon një platformë të rëndësishme për zbatimin e drejtë dhe transparent të politikave për nëpunësit civilë.

Për ta përmirësuar edhe më tej segmentin e organizimit të administratës publike në Kosovë, është hartuar edhe analiza cilësore e agjencive të pavarura, e cila, pos tjerash, nxjerr në pah edhe elemente që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës në këto institucione, kompensimet e zyrtarëve përkatës, si dhe organizimin e institucioneve gjegjëse.

Sa i përket pakos strategjike për reformën e administratës publike, ajo përbëhet nga 4 dokumente strategjike, si vijon: Strategjia për modernizimin e administratës publike, Strategjia për rregullim më të mirë, Strategjia për përmirësimin e planifikimit dhe koordinimit të politikave në Kosovë dhe Strategjia për reformën e menaxhimit të financave publike të Kosovës. Po ashtu, në muajin qershor të vitit që po e lëmë pas, kemi miratuar edhe Strategjinë për trajnime të nëpunësve civilë 2016-2020 dhe planin përkatës të veprimit

Gjithashtu, për ilustrim të zbatimit të dokumenteve të lartpërmendura, në fillim të vitit të ardhshëm, do ta lansojmë projektin elektronik “e-kutia”, të mbështetur nga UNDP, që ka të bëjë me matjen e opinionit të qytetarëve për të gjitha shërbimet që ofrohen nga administrata e Republikës së Kosovës. Nga zbatimi i pakos strategjike, rezultojnë edhe hartimi i planeve të integritetit në një mori institucioneve të Republikës së Kosovës, që janë duke u mbështetur nga UNDP. Si çështje tjetër relevante, është qëndrueshmëria financiare e procesit të reformës së administratës publike, ndërsa sfidueset mbetet kostoja e saktë e të gjitha aktiviteteve reformuese, si dhe sigurimi i buxhetit të nevojshëm për zbatimin e tyre. Aktualisht, ndodhemi në fazën finale të

përcaktimit të indikatorëve që do të përfshihen në kontratën e ardhshme për mbështetje buxhetore në sektorin e reformës së administratës publike, që pritet të nënshkruhet midis Qeverisë së Kosovës dhe Komisionit Evropian. Është përcaktuar se deri në muajin janar të vitit 2017, Qeveria e Kosovës do ta informojë Komisionin Evropian se si mbulohet pakoja strategjike e reformës së administratës publike në buxhetin e vitit 2017 dhe në Kornizën afatmesme të shpenzimeve.

Time Kadrijaj, pyeti ministrin: Çka do të ndërmarrë ministria juaj ndaj këtyre obligimeve dhe detyrave që ka sipas reformës për agjendën evropiane, a keni ndonjë plan të punës apo keni ndonjë agjendë tjetër në përmbushjen e këtyre obligimeve?

Fatmir Xhelili, theksoi se pyetja ndoshta nuk ka të bëjë drejtpërdrejt me raportin, por e konsideron të rëndësishme. Pyeti: A e keni bërë identifikimin e pronës apo objekteve që disponon ministria dhe çka jeni duke ndërmarrë në mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pronave, të cilat nuk janë të shfrytëzueshme, çka keni planifikuar për to dhe a keni kërkesa nga institucionet tjera për shfrytëzimin e tyre, apo keni ndonjë plan konkret për shfrytëzimin e atyre pronave?

Ministri Yagcillar, theksoi se në aspektin e pakos legjislativë, është kërkesa që të bëhet renditja në miratimin e ligjeve, të procedohen 3 ligje, së bashku dhe të miratohen në Kuvend, siç janë: Ligji për administratën publike, Ligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për shërbyesit civilë dhe Ligji për pagat nga buxheti i Republikës së Kosovës. Sipas dokumenteve të lartpërmendura, ne si ministri, jemi të obliguar që të dërgojmë në Qeveri aplikimin e koncept-dokumenteve, pastaj pas miratimit, t'i procedojmë për miratim në Kuvend. Do të kemi sfida të mëdha deri në miratimin e këtyre ligjeve, sepse këto çështje janë të ndërlidhura me funksionimin e aparatit shtetëror, krijimin dhe shuarjen e disa institucioneve dhe shumë çështje tjera.

Sa i përket kapaciteteve të Ministrisë së Administratës Publike, janë të kufizuara, sepse duhet të zbatohen edhe të gjitha çështjet që kërkohen nga Komisioni Evropian, por ka mungesë të kapaciteteve në Departamentin për Reformën e Administratës Publike dhe në Departamentin për Integritet Evropian, por jemi duke menduar për bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Integritetit Evropian, që t'i realizojmë të gjitha veprimet që dalin nga dokumentet e lartpërmendura.

Kurse, sa i përket Reformës së Agjendës Evropiane dhe obligimeve që dalin, në njëfarë mënyre, ka të bëjë me këto çështje.

Sa i përket Ligjit për pagat, ai tha se deri më tani nuk ekziston në Kosovë, por është vetëm Ligji për pagat e shërbyesve civilë, i cili nuk zbatohet, por, tani, për herë të parë, do të jetë një ligj, i cili do të përfshijë të gjithë përfituesit e pagave nga buxheti i Kosovës dhe do t'i përfshijë të gjithë shërbyesit civilë, nga aspekti i statusit. Ligji për shërbyesit civilë është duke u zbatuar, por ka nevojë për plotësim dhe besoj që, deri në fund të vitit, së bashku do ta miratojmë. Jemi duke punuar që në këtë ligj të ketë transparencë më të madhe, që do të thotë se ka të bëjë me përzgjedhjen e sekretarëve të përgjithshëm dhe drejtorëve, sipas meritës. Kurse, sa i përket menaxhimit të objekteve publike, jemi duke i menaxhuar ato objekte, ku nuk paguhet qira. Të gjitha objektet i kemi në evidencë, por ka nevojë që të miratohet një ligj, i cili do ta përcaktojë regjistrin dhe do t'i rregullojë çështjet, sa i përket pronësisë, dhe në këtë rast, besoj se do të jetë Ministria e Drejtësisë, sponsore, sepse ata i kanë disa iniciativa.

Bislim Zogaj, pyeti: Në Ligjin për pagat, a do të përfshihen agjencitë dhe kompanitë private?

Ministri, tha se së pari duhet të rregullohet në ligj, se kush përfiton pagën nga buxheti i Kosovës, por ekziston edhe mendimi që të japim edhe disa formulime se si do të rregullohen pagat edhe në ndërmarrjet publike, që të ketë një harmonizim midis pagave. Kurse, ndërmarrjet private nuk përfshihen, por vetëm mund të ketë sqarime për ta, se si do ta bëjnë kategorizimin e pagave, kurse ndërmarrjet publike i kanë bordet e veta dhe ata menaxhojnë sipas performancës.

Kryetarja falënderoi ministrin për raportim të detajuar.

Pas diskutimeve dhe raportimit të ministrit, kryetarja konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, nxori këtë

Rekomandim

Miratohet, me shumicë votash, Agjenda për Reforma Evropiane (ARE) dhe i procedohet Kuvendit për miratim.

- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor, duke konstatuar se ky projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.

Lidhur me këtë projektligj, hapi diskutimin.

Pasi nuk kishte vërejte, kryetarja konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, nxori këtë

Rekomandim

Projektligji për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.

Të ndryshme

Për këtë pikë nuk kishte çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetare e Komisionit,

Njomza Emini